

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
BYROJA PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

PROGRAMI PËR AKTIVITET PROJEKTUES

**PAQË, TOLERANCË DHE SIGURI**

Shkup, 2005

## 1. HYRJE

Aktivitetet projektuese janë risi në sistemin arsimor në Republikën e Maqedonisë, të cilat për herë të parë janë vendosur me reformën në arsimin gjimnazor prej vitit 2003/04, kurse prej këtij viti shkollor 2005/06 janë si një mundësi për realizimin në pjesën e Planit mësimor- Orë të lira në shkollat profesionale.

Nevoja për modernizimin e arsimit, gjegjësisht inkuadrimi i nxënësit në punë hulumtuese dhe mundësi t'i tregojë njohuritë e veta, nevojat dhe interesimin, paraqesin aktivitet të ri edukativo-arsimor, mënyrë të re të punës së nxënësit dhe arsimtarit, komunikim dhe bashkëpunim të ndryshëm. Aktivitetet projektuese janë në funksion edhe të përgatitjes të nxënësit për përpilimin të detyrës projektuese nga provimi i maturës, inkuadrimi në sistemet bashkëkohore të shkollimit në arsimin sipëror ose në jetën e përditshme.

### **Aktivitetet projektuese nga lëmia: Paqë, tolerancë dhe siguri**

- Aktivitetet u mundshme projektuese dhe përmbajtjet
  - Qëllimet - e përgjithshme dhe të posaçme
  - Aktivitet projektuese ( Fazat e realizimit )
  - Mënyra e organizimit dhe realizimi i aktivitetve projektuese
  - Kushtet për realizimin e aktiviteve projektuese
  - Evaluimi - kriteret, mjetet dhe mënyrat
- Planifikimi i aktivitetit projektues nga ana e arsimtarit duhet të jetë fleksibil dhe i përshtatur në punën hulumtuese të nxënësve. Arsimtari duhet të bën planifikimin për 30 orë në shkollë, të cilat i ndan gjatë realizimit të aktivitetit të tërë projektues, sipas vlerësimit të vet dhe për 40 orët e tjera të cilat nxënësi i realizon në mënyrë të pavarur, mirëpo vazhdimisht e përcjell dhe i shënon aktivitetet e nxënësit. Nxënësi e udhëheq dosien e vet - portfolien në të cilën i shënon aktivitetet e veta. Nëse nxënësi nuk e realizon aktivitetin e vet të zgjedhur përkatës projektues, domethënë nuk ka realizuar pjesë nga plani mësimor për arsimim të gjimnazit dhe duhet ti mundësohet nxënësit që deri në fillimin e vitit të ardhshëm shkollor ta realizoj aktivitetin projektues, i cili më tutje evidentohet në dokumentacionin pedagogjik.
- Puna hulumtuese e nxënësit, udhëzimi në metodologjinë e hulumtimit, zgjedhja, prezentimi i temës së zgjedhur dhe aktuale në pajtueshmëri me dëshirën, afinitetin dhe aftësin e tyre. Në atë mënyrë inicohet kreativiteti, krijimtaria individuale e shprehja e nxënësit si dhe aftësimi për punë të vetësishme ose punës ekipore në projekteve.

- Nxënësi ka mundësi ti zbuloj potencialet dhe talentin e vet ndaj ndonjë lëmie ose sferë të caktuar, ti shpreh njohuritë, të njejtat ti thelloj, ti zgjeroj dhe ti aplikoj si dhe ta vërej suksesin dhe kënaqësinë nga realizimi i aktivitetit projektues.
- Nxënësi udhëzohet në punën të vetësishme hulumtuese, me shfrytëzimin e literaturës, internetit dhe burime tjera të njohurive.
- Në atë mënyrë nxënësi i plotëson dhe i zhvillon nevojat kulturore në mjedisin në të cilin shkollohet, në mjedisin lokal dhe jashta tyre. E zhvillon komunikimin në relacion arsimtar-nxënës në mënyrë të re ku arsimtari është në rolin e mentorit. Te nxënësi formohen dhe forcohen karakteristikat pozitive të personalitetit siç janë : vetbesimi, vullneti, qëndrueshmëria dhe principialiteti etj.

## 2. QËLLIMET E AKTIVITETEVE PROJEKTUESE

### 2.1. Qëllimet e përgjithshme

#### Nxënësi:

- Të fitojë njohuri dhe dituri , ta promovojë kulturën e paqes dhe të veprojë si personalitet paqedashës dhe integruet në proceset demokratike të Republikës së Maqedonisë.
- Të aftësohet për komunikim më të gjërë, bartës i transformimit të marrëdhënieve në shoqërinë dhe të angazhohet kundër tjetërsimit, dizentegritimit dhe degradimit prej çdo forme ; t'i kuptojë vlerat universale dhe demokratike, të zhvillojë aftësi për përgjegjësi personale dhe shoqërore si dhe respektimin e tyre;
- Të arrijë aftësi dhe njohuri për siguri personale dhe kolektive , sigurim;
- Udhëzimi dhe aftësimi i njeriut të ri për punë hulumtuese.

### 2.2. Qëllimet konkrete:

Qëllimet konkrete të aktiviteteve projektuese janë që nxënësi:

- Të arrijë dituri elementare për paqen, kulturën e paqes, aspektet negative dhe pozitive të paqes për krijimin dhe ruajtjen e saj.
- Të formojë raport pozitiv ndaj atdheut, vlerave universale dhe demokratike;
- Të zhvillojë përgjegjësi për respektimin e dinjitetit nacional dhe vlerave tjera.

- Të dijë që t'i respektojë dhe t'i zbatojë të drejtat dhe liritë personale si dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve
- Të fitojë njohuri elementare dhe aftësi për aksion paqësor dhe paqëruajtës
- Të zhvillojë vetëdije dhe përgjegjësi për sjelljen vetanake ndaj dhunës dhe padrejtësi si dhe përgjegjësi ndaj të tjerëve në

relacionet shoqërore.

- Të zhvillojë aftësi për aksion në proceset e ndryshimeve, të cilat janë pjesë nga marrëdhëniet ndërmjet individëve, grupeve, shoqërisë dhe bashkësisë ndërkombëtare.
- Të zhvillojë aftësi për ripërtrirjen e relacioneve të çrregulluara midis individëve, grupeve dhe bashkësive
- \*Të fitojë njohuri elementare për kanosjet dhe rreziqet të cilat rrezikojnë paqen
- Të zhvillojnë aftësi personale për prevencë dhe siguri nga kanosjet dhe rreziqet
- Të fitojë njohuri për manifestimet e ndryshme të dhunës prej nivelit personal deri te aj global (lufta dhe konflikti i armatosur)
  - Të zhvillojë vetëdije dhe aftësi për parandalimin e dhunës dhe transformimin e padhunshëm të konflikteve
  - Të fitojë njohuri për vendosmërinë ndërkombëtare në raport me ruajtjen e paqes dhe sigurisë
  - Të njoftohet me rolin dhe pozicionin e shtetit në ruajtjen dhe garantimin e paqes dhe sigurimit në nivelin individual, nacional dhe ndërkombëtar
- Të fitojë njohuri dhe aftësi për zbatimin e masave për siguri personale dhe kolektive dhe të merr pjesë në sigurinë civile
- T'i përcjell njohuritë e fituara dhe t'i zbatojë aftësitë në përmbajtjet tjera mësimore në suazat e arsimit civil
- Të aftësohet për hulumtim dhe punë në projekte

### 3. LËMI DHE TEMA

#### 3.1. LËMIA: RREZIKIMET DHE RREZIQET

#### TEMAT DHE PËRMBAJTJET

#### RREZIKIMET DHE RREZIQET

7

Aktivitetet dhe përmbajtjet e mundëshme projektuese	<b>Qëllimet konkrete</b>	<b>Aktivitetet</b>	<b>Drejtimitet didaktike</b>
---	--------------------------	--------------------	------------------------------

<p><b>RREZIKIMET DHE RREZIQET</b></p> <p>Burimet dhe format</p> <p>1.Rrezikimet shoqsërore</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Konfliktet dhe zgjidhja e tyre,</li> <li>- Lufta,</li> <li>- Terorizmi dhe kërcnimet mbi paqen dhe sigurin ndërkombëtare</li> <li>-Kërcnimet mbi paqen dhe sigurinë nacionale,</li> <li>-Kriminali,</li> <li>-Dukuritë socio-patologjike, llojet e ndryshme të varshmërisë dhe siguria nga ato</li> </ul>	<p><b>Nxënësi :</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Ti njohë, t'i dallojë dhe t'i definojë: llojet e ndryshme dhe dukuritë e kërcnimeve dhe rreziqeve : lufta, konflikti ndërkombëtarë, terorizmi ndërkombëtarë; kërcnimet mbi sigurinë individuale dhe nacionale;</li> <li>-Ti zbulojë dhe t'i analizojë shkaqet e konflikteve dhe veprimet për ballafaqimin me ato: prevenca, zgjidhja dhe transformimi i konflikteve;</li> <li>-Ti njohë dhe ti përshkruajë llojet : terorizmit dhe sjelljes kriminele; dhe mënyrat për ballafaqimin me ato në nivelin nacional dhe ndërkombëtarë</li> </ul>	<p>Aktivitetet organizohen dhe realizohen në bashkëpunim me nxënësit, gjejnë mirëkuptim për tipin dhe llojin e aktivitetin të cilat janë në përputhshmëri me kushtet të cilat i posedon shkolla.</p> <p>Aktivitetet mund të jen si puntori, kabinetik dhe në teren(jasht shkolle)</p> <p>Aktivitetet kabinetike realizohen në shkollë me çrast shfrytëzohen: tabela, panoa, skema të cilat i përshkruajnë rrezikimet(video/CDRom), dhe tekstet të cilat janë bazë për hulumtime, debate dhe diskutim, grafoskop, kompjutor, fletëza pune dhe literaturë doracake etj.</p> <p>Aktivitetet në teren janë në marrëveshje me nxënësit, sipas mundësisë jashtë shkolle me analiza dhe hulumtime të vetësishme në temën aktuale.</p>	<p><b>Format e punës:</b></p> <p>Nxënësit individualisht të ndarë në grupe ose në çifte bëjnë hulumtime të cilat më pas i prezentojnë në mënyra të ndryshme.</p> <p><b>Metodat mësimore:</b></p> <p>Monologe, dialoge dhe tekst metoda si dhe metoda e ilustrimit dhe e demonstrimit, hulumtimi i vetësishëm i nxënësve.</p>
<p><b>2. Rrezikimet natyrore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Tërmetet</li> <li>-Vërshimet</li> <li>-Thatësitrat</li> <li>-Breshëri</li> <li>-Ortiqet e borës etj.</li> </ul> <p>3.Rrezikimet Teknike-Teknologjike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Zjarret, prevenca dhe siguria</li> <li>-Havaritë nukleare, kimike dhe biologjike</li> <li>-<b>Kontaminimi,</b></li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-Ti njohë dhe ti dallojë rrezikimet natyrore dhe rreziqet, të veprojë në mënyrë përkatëse në situatën e dhënë për sigurinë personale dhe sigurinë e mjedisit natyrorë.</li> <li>-Të veprojë në mënyrë preventive për sigurinë personale dhe sigurinë e mjedisit natyror nga rrezikimet dhe degradimi ;</li> <li>-Të aftësohet për vetiniciativë dhe hulumtim të vetësishëm të situatave në atë sferë ;</li> <li>- Të bëjë analizë komparative të parametrave ekzakte kuantitative ;</li> <li>-Të veprojë në mënyrë të drejtë në situatën e dhënë për prevencë dhe</li> </ul>	<p>Aktivitetet në teren ( praktike) do të nënkuptojmë stimulimin e situatave të krizës dhe veprimi ndaj tyre.</p> <p>Preferuese është që të bëhen imitacione të më tepër të llojeve të rrezikimeve dhe rreziqeve ( simulim )</p> <p>E cila mund të punohet në më tepër grupe dhe të prezentohet para shkollës ose mjedisit të lokalitetit.</p> <p>Informativisht mund të shfrytëzohet kabineti i informatikës për udhëheqjen e miniproekteve me shkollat tjera nga vendi dhe nga rajoni nëpërmjet internetit.</p> <p>Mund të bëhet vizitë e Ministrisë për mbrojtje dhe strukturave të saja dhe Sigurisë Civile, MPB, Ministrisë për arsim dhe shkencë, institutit për <b>studime</b></p>	<p><i>Mësimdhënësi mirret vesh me nxënësit për aktivitetet të cilat do të realizohen si projekte</i></p>

<p>4. Bashkësia ndërkombëtare dhe paqja</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- OKB</li>   <li>- UE</li>   <li>- OSBE</li>   <li>- NATO</li> </ul>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- ta njeh zhvillimin e OKB- së, qëllimet, parimet, mekanizmat e veprimit dhe rruajtjes së paqes;</li> <li>- ta njoh strukturën e OKB-së;</li> <li>- të dij pse dhe kur i mban seancat e veta këshilli i sigurimit;</li>   <li>- Unioni European nga ideja e deri në realitetin e Maqedonisë në atë rrugë.</li>   <li>- T'i njohë qëllimet e OSBE-së dhe mekanizmat e veprimit;</li>   <li>- Ta dijë rolin e NATO-së dhe transformimin e saj në sistemin kolektiv të sigurisë në funksion rruajtjes së paqes dhe luftës kundër terrorizmit;</li>   <li>- Ta dijë vendin, rolin dhe perspektivat e R së Maqedonisë si pretendent e antarsimit në NATO.</li> </ul>	<p>Aktivitetet me qëllim të informimit sa më të gjërë dhe njohjen e nxënësve për rolin e institucioneve ndërkombëtare në Maqedoni dhe më gjërë për rruajtjen e paqes, stabilitetet dhe zhvillimin e rajonit dhe përparimin në planin ekonomik</p> <p>Për at qëllim nxënësit udhëzohen që ti përcjellin ndikimet dhe informacionet e përditshme në Republikë dhe më gjërë, ta shfrytëzojnë shtypjen, literaturën, të bashkupunojnë me institucionet ndërkombëtare joqeveritare si shkollë dhe si individ, duke u inkuadruar dhe duke dhënë kontributin si qytetarë të këtij shteti.</p>	<p><b>Format e punës:</b> Frontale, grupe, individuale, në çifte- nxënësit udhëheqin projekte, bëjnë hulumtime të cilat i prezantojnë në mënyra të ndryshme ( eseje, panoa, debate ).</p> <p>Metodat mësimore: Monologe, dialoge, tekst metoda, hulumtimi i vetësishëm, demonstrimi, ushtrimi në grupe etj.</p> <p>Mjetet mësimore: Grafoskopi, panoa, videoja, televizori, fotografitë, tekstet, dokumentet ndërkombëtare, deklaratat, filmat dokumentarë, emisionet nga mediumet etj.</p>
---	---	--	---

## TITUJT E MUNDSHËM PËR PROJEKTE NGA LËMIA: REZIKIMET DHE RREZIQET NË VENDIN TONË

- Katastrofat më të mëdha natyrore në botë
- Tërmetet dhe pasojat e tyre te ne
- Vërshimet dhe siguria nga ato
- Thatësira, a ekziston siguria?
- Pasojat dhe siguria nga zgjaret në natyrë
- Rreziku ndaj Republikës së Maqedonisë nga havaritë nukleare në rrethinë
- Rreziku ndaj qytetit nga havaritë kimike
- Kontaminimet
- Veprimi i dëmshëm i radiacionit
- Epidemitë ( Pasojat dhe siguria )
- Ndotjet :
  - Ujrat - Vardar,
  - Ajri - Veles,
  - Truall - Shkup
- Si të zvoglohet numri i aksidentëve të trafikut
- Sjellja kriminale e të rinjëve
- Kriminaliteti i organizuar
- Dukuritë socio-patologjike dhe të rinjtë
- Varshmërit dhe shkatrimi i tyre:
  - Pirja e duhanit
  - Alkoolizmi
- Tregtia me njerëz
- Vetëvrasjet...
- Paqe: pozitive - negative
- Terorizmi lokal
- Terorizmi global
- Roli i OKB - së në ruajtjen e paqes
- Struktura e OKB - së
- Roli i këshillit për sigurim

### **Rekomandim :**

Arsimtari në marrëveshje me nxënësin e përcakton titullin e temës për projektin si dhe vëllimin, mënyrën, kushtet, vendin etj. të punës.



- Narkomania

- UE - nga ideja gjer në realitet
- OSBE - garancë e sigurisë
- NATO - themelimi dhe transformimi i saj
- Republika e Maqedonisë në NATO
- Maqedonia drejt proceseve evropintergruese
- Shenjtarija si aktivitet projektues ( zhvillimi i shenjtarisë, rëndësia, disiplinë olimpike dhe ushtrimet praktike )

Arsimtari është i obliguar të caktoj standarde për përpunimin e projekteve ( vëllimin, mënyrën e punës, afatin e përpunimit, format e të ngjashme ) dhe në fletë të veçant tua jep të gjithë nxënësve të grupit.

Grupet formohen sipas interesit, afinitetit dhe dëshirës së nxënësve, ashtu që të mundën më sa lehtë të përcaktohen për aktivitetin projektues e cila më së shumti i përgjigjët nevojave të tyre edukative, kurse arsimtari duhet ta sqaroj temën nga e cila do të përpunohen aktivitetet e mundshme projektuese dhe të ketë rol të mentorit. Arsimtari dhe nxënësit mundën vet të propozojnë tema të reja dhe aktivitete nga lëmia e njejtë, të cilat janë në pajtueshmëri me nevojat dhe interesin e nxënësve. Në këtë mënyrë mundësohet orientimi më i saktë gjatë strukturimit të temës mësimore, kurse njëherit jep zgjedhje më të begatshme për aftësimin e përmbytjeve mësimore nga interesimi, dëshirat dhe nevojat e nxënësve.

Terminet për mbajtjen e orëve përcaktohen sipas dinamikës në shkollë, pasi që të formohen grupet.

## LËMIJA E AKTIVITETIT PROEKTUES: VLERAT THEMELORE TË VENDIT TONË

Temat dhe përmbajtjet

Aktivitetet dhe përmbajtjet e mundëshme	Qëllimet konkrete	Aktivitetet	Drejtimitet didaktike
<p>VLERAT THEMELORE TË VENDIT TONË</p> <p>-Sovraniteti dhe integriteti territorial</p> <p>-Të drejtat dhe liritë e qytetarëve</p> <p>-Sundimi i së drejtës</p>	<p><b>NXËNËSI :</b></p> <p>-T'i njeh vlerat themelore të vendit;</p> <p>-Të dijë për sovranitetin dhe integritetin territorial të RM dhe rëndësia e tyre;</p> <p>-Ta zhvillojë ndjenjën dhe nevojën për kultivimin dhe ruajtjen e saj</p> <p>-Ti vërejë dukuritë e rrezikimit të tyre;</p> <p>-Ti dijë dhe ti zbatojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit.</p> <p>-Të dijë të praktikojë dhe të zhvillojë marrëdhënie mbi tolerancën ndëretnike dhe ndërkonfesionale.</p>	<p>Aktivitetet realizohen si kabinetike, në shkollë, jashtë shkolle me vizita në institucionet e caktura të punojnë dhe jaë të lidhura me përmbajtjet dhe sferat të cilat realizohen me projekt.</p> <p>Për realizimin e aktiviteteve shfrytëzohen: Kushtetuta e RM, hartat, skemat, kompjutorë për projekteve hulumtuese dhe lidhshmërinë më shkollat tjera të republikës dhe rajonit të Europës juglindore.Do të organizohen puntori dhe ushtrime me: debate, diskutime, eseje, fleta pune dhe të ngjashme.</p> <p>Nxënësit për punë të vetësishme hulumtuese do të jenë të drejtuar në bashkëpunimin me institucionet joqeveritare, ndërkombëtare etj</p>	<p>FORMAT E PUNËS: Frontale, individuale, grupe dhe çifte.</p> <p>METODAT MËSIMORE: Monologe, dialoge dhe metoda tekstuale dhe metoda ilustrimit dhe demonstrimit si dhe me shfrytëzimin e metodologjisë së punës hulumtuese.</p> <p>MJETET MËSIMORE: Mund të shfrytëzohen: harta, tabela, grafoskop, kompjutorë me internet, fletat e punës, doracakë dhe literaturë përkatëse, ligjet deklaratat, dokumentet ndërkombëtare, si nga OKB-ja, Unioni Europian, OSBE-ja...</p>

<p>-Demokracia dhe pluralizmi politik</p> <p>-Liria e tregut dhe e sipërmarjeve</p> <p>-Vlerat tjera themelore të rendit kushtetues</p>	<p>-Të dijë t'i respektojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve;</p> <p>-Të zhvillojë ndjenja patriotike të përkatësisë nacionale dhe atdheut të përbashkët të të gjithve në të;</p> <p>-Të zhvillojë aftësi për respektimin e të drejtave dhe lirive të personave tjerë dhe krupëve si dhe të drejtën e të dalluarit;</p> <p>-Ti njohë vlerat tjera themelore dhe ta përforcojë vetëdijën për lidhshmërinë e tyre dhe domosdoshmërinë të gjitha së bashku të kultivohen dhe të zhvillohen ( të përparohen )</p>	<p>Nga sistemi të cilat punojnë në problematikën dhe sferën e njëjtë.</p>	<p><b>REKOMANDIM:</b></p> <p>Ndarjen e temave për projektet dhe shqarimin mënyrës së përpunimit të projekteve e bën arsimtari në konsultim dhe pajtueshmëri me nxënësit sipase interesave dhe dëshirave të tyre.</p>
---	--	---	--

## **MODEL I PUNËTORISË PËR ,PADHUNË , KOMUNIKIM, BASHKËPUNIM, TRANSFORMIM DHE ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE**

**(Shtojca nr. 1)**

**Vërejtje:** Në njërin nga vitet mësimore nxënësit mund ta zgjedhin këtë model të punëtorisë, por për të njëjtën nevojitet trajnim i arsimtarit: Të njëjtën e punon Prof. Andonakis Takis në Gjinnazin Josip Broz -Shkup, për të cilën është i specializuar

### **4. ORGANIZIMI DHE REALIZIMI I AKTIVITETEVE PROJEKTUESE**

Aktivitete projektuese praktikohen në kuadër të 70 orëve në vjet në formë të punëtorive, që mund të realizohen në kabinete, sipas rregullave, në shkollë dhe terren si vizitë në institucione dhe organizata, pushtetin vendor etj. Ato janë jashta orarit mësimor kurse së bashku të planifikuara me kohën dhe lokalitetin e arsimtarit dhe nxënësit. Bartës kryesor i organizimit të aktiviteteve projektues është shkolla e cila për ndonjë problem të mundshëm mund të drejtohet në Byronë për Zhvillimin e Arsimit. Arsimtari është i detyrueshëm të paraqesë standarde për përpunimin e projektit (madhësia, mënyra e punës, afati i përpunimit, formati etj ). dhe në fletë të veçantë t'iu jep të gjithë nxënësve të grupit.

Grupet projektuese formohen sipas interesimit, afinitetit dhe dëshirës së nxënësve, kështu që më sigurtë të mund të përcaktohen për aktivitetin projektues i cili më shumë iu konvenon për nevojat e tyre edukative, kurse arsimtari duhet ta sqarojë temën që do të përpunohen aktivitetet e mundshme projektuese dhe të ketë rol të udhëheqësit, proietmenaxhues, përkatësisht mentor. Arsimtari dhe nxënësit vetë mund të propozojnë tema të reja dhe aktivitete nga e njëjta lëmi, të cilat janë përkatëse në nevojat dhe interesin e nxënësve. Në këtë mënyrë mundësohet orientim më preciz gjatë strukturimit temës mësimore drejtë interesimit, dëshirave dhe nevojave të nxënësve. Terminet për orët përcaktohen sipas dinamikës në shkollë, atëherë kur do të formohen grupet.

Për të arriturat e qëllimeve të aktiviteteve projektuese nga paqa dhe toleranca është e **domosdoshme** të praktikohen metodat interaktive bashkëkohore, teknikat e punës si: **punë individuale të nxënësve, metodë e punëtorisë-ushtrime, metodë hulumtuese, stimulimi dhe luajtja e roleve, metodë të pavarur, individuale ose punë në grupe të projekteve : metoda demonstruese -ilustruese: poster-prezentim, ekspozita, gazeta shkollore, video filma, CD rom, disketa ose rezultatet të jenë të parashtruara në internet, fushata etj, në bashkëpunim me shkollat, institucione (qeveritare dhe joqeveritare) tjera dhe ekspertë të lëmi të ndryshme.**

Mund të shfrytëzohen edhe kombinime: frontale, grupore dhe tandem forma, individuale, direkte dhe indirekte, por më shpeshë duhet të praktikohet ajo individuale dhe grupore ku mundësohet çdo nxënës të udhëzohet drejtë punës individuale të pavarur në shkollë dhe jashta saj ose

formë grupore që jep mundësi për punë në projekt të përbashkët dhe prezentim të njëjtit. Forma grupore ka komponenta edukative: nevoja për afirmim të grupit që e përforcon motivimin e individit, anëtar i grupit, bashkëpunim reciprok. Nxënësit të ndarë në grupe veçanërisht në kuadër të punës kryejnë hulumtimet e tyre që i shprehin në mënyra të ndryshme; teza, eseje, modele, vizatime etj. Nxënësit e grupeve marrin detyra të ndryshme që të përpunojnë lëmi të caktuara ose përmbajtje nga projektet që më vonë do të prezentohen në shkollë, në nivel të aktivitetit të aktiviteteve projektuese përmes shkollave tjera etj. Dmth, arrihet udhëheqje dhe organizim demokratik, transparencë të së drejtave dhe informatat në nivel të shkollës dhe angazhimi në bashkësinë lokale dhe më gjërë. Puna në çifte - tandem gjithashtë është rekomanduese për atë që nxënësit që rrijnë së bashku ose shoqërohen mund t'i zgjedhin problemet e parashtruara rreth projektit, kurse njëri prej tyre të jep përgjigje.

**Roli i arsimtarit: planifikon,** përgatitje (lokale, mjete mësimore didaktiko-metodike) parashtron problem, jep drejtime, vëzhgon, ndihmon, koordinon dhe mbikqyr punën në grupe dhe individë, prezenton informata, demonstroi, përcjell, vlerëson (punën e vet dhe të nxënësve) dhe vendos komunikim pozitiv pedagogjik me nxënësit dhe arsimtarët. Ai i udhëheq grupet projektuese dhe projektet e tyre, përgjegjës është për organizimin dhe mënyrën ku bën pjesë grupi projektues dhe doemos të jetë në gjendje që ti njeh problemet, për ato të interesohet dhe me bashkëpunëtorët e tij të mundohet të gjejë zgjidhje sistematike dhe konstruktive. Për tërë këtë punë mban evidencë në ditarin e paraleles, të cilën pastaj e shkruan në dokumentacionin e nxënësit.

### **Disa karakteristika të arsimtarit - mentorit**

Arsimtari që realizon aktivitet projektues nga Paqa, toleranca dhe siguria në gjimnaz duhet të posedojë karakteristika të larta personale, profesionale-pedagogjike: kompetent profesional në mësimin, partner dhe pedagog në komunikim me nxënësit, i përgatitur për zgjidhje përkatëse didaktike për situatat në shkollë, mentor, motivues, vlerësues objektiv i diturive dhe shkathtësive të nxënësit dhe vlerësues i mundësive të mundshme objektive të nxënësit, edukatorë, personalitet pozitiv.

Ai i orienton dhe i vendos nxënësit në punë hulumtuese, iu sqaron se si punohet në projekt, çka përmban një projekt, dmth. në mënyrë procedurale i përcjell dhe i shpie në pavarësimin e tyre.

**Aktivitetet e nxënësit:** interesohet, parashtron pyetje, tregon mendim, ofron zgjidhje, hulumton, vëzhgon, zbulon, evidenton të dhëna, kontrollon, diskuton, sjell qëndrime edhe në bashkëpunim me arsimtarin harton projekt.

Ai udhëheq portfolion e tij, të cilën e kontrollon arsimtari.

Të arriturat e nxënësve duhet të jenë rezultat i arsimtarit dhe edukuesve të tij edhe atë si: komunikim i mirë, përcjellje të vazhdueshme dhe të kontinuar në përparimin dhe ndryshimet e tyre. Arsimtari duhet të mundësojë: nxënësit të punojnë në atmosferë të mirë dhe humane, e më pas të motivohen, të jenë ambicioz, tolerantë dhe të ndershëm në mendimet dhe qëndrimet e tyre.

Arsimtari gjithë këtë do ta arrijë vetëm nëse është profesionalist dhe kompetent në mësim, partner me arsimtarët, me zgjidhje përkatëse didaktike për situatat në klasë dhe në terren dhe vlerësues në mundësitë objektive të nxënësit, partner në marrëdhëniet emocionale, edukatorë dhe individ pozitiv.

Arsimtari e përcjell nxënësin e tij me përparimet e tij dhe në fund të vitit nxënësi merr vërtetim se ka realizuar aktivitete nga lëmi i paqës, tolerancës dhe siguri dhe kjo i shënohet në dëftesë.

## **5. BASHKËPUNIMI**

Bashkëpunimi realizohet në më shumë nivele: midis vetë nxënësit dhe arsimtarët, në nivel të shkollës në tërësi, me shkolla tjera, me bashkësinë lokale dhe më gjerë, me organizata (qeveritare dhe joqeveritare) që merren me këtë problematikë.

**Aktivitetet projektuese nga paqë, tolerancë dhe siguri i ligjëron profesor i diplomuar i lëndës së mbrojtjes dhe studimeve paqësore (defektolog)**

**Programin e hartoi këshilltarja, Sofka Koceva në bashkëpunim me profesorin Takis Andonakis dhe Liljana Trajkova.**